

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Goli 8.6 milionë dollarë i Ron Yeffet edhe me këmbën e narkogjatësisë?
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/goli-86-milione-dollarë-i-ron-yeffet-edhe-me-kemben-e-narkogjatesise-i474016
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 18:48:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 11:44:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	59d572602b2d8c3b43079b3716a097b36eeb01f1df852c24536d3ce244316fc5
TEKSTI	aa3205478be27771c89cef15386ba35727978b4d29f0bcd6cb8ed45412e91ef7
PAMJA	ce1a1118e234c87995785f3833868e690abd3502c00dc7563587e058005b8798

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3aa62598a0e4a9e4229e47fc80a0d6d1176612b7f4c4274239f6dd7fdba5f4d5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3aa62598a0e4a9e4229e47fc80a0d6d1176612b7f4c4274239f6dd7fdbe5f4d5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x


20:45 Aktualitet

Gazetari Klodian Tomorri ka reaguat lidhur me atë që e qua...

Goli 8.6 milionë dollarë i Ron Yeffet edhe me këmbën e narkogjatësisë?



13 Shtator 2026, 13:44, Aktualitet CNA



Gazetari Basir Çollaku, në një postim në rrjetet sociale është shprehur se ndaj biznesmenit Ron Yeffet është depozituar një kallëzim në Gjykatën e Miami-t nga biznesmeni Mark

Faist.

Ky i fundit, sipas kallëzimit, ka rënë pre e një operacioni mashtrimi të Yeffet për blerje pronash në Neë York. Çollaku shprehet se Ron Yeffet e ka takuar biznesmenin amerikan, në nëntor të 2020, me kryeministrin Edi Rama.

Gazetari shkruan më tej se në kallëzim, Faist deklaroi edhe një udhëtim në Shqipëri me Yeffet ku u takuan dhe biseduan me shumë zyrtarë të lartë shtetërorë dhe se ai i kishte premtuar pasaportë shqiptarë.

Ai shton se nga 8.6 milionë dollarë, Yeffet i ka kthyer biznesmenin amerikan vetëm 1 milion. Sipas Çollakut, Yeffet është përgjigjur me kundërpadi ku i kërkon 30 milionë dollarë Markut "si pasojë e dëmtimit të reputacionit nga kallëzimi i tij dhe që ka sjellë për pasojë përjashtimin e Ronit nga një projekt madhor shqiptar ndërtimi ku humbi direkt 30 milionë dollarë fitime të garantuara".

Postimi i plotë:

Më 6 mars 2026 biznesmeni amerikan Mark Faist ka depozituar një kallëzim në Gjykatën e Miami-t, SHBA kundër Ron Yeffet për t'i kthyer shumë 8.6 milionë dollarw dhënë atij për megaprojekte të përbashkëta imobiliare në Nju Jork.

Sipas kallëzimit, Mark Faist ra viktimë e një operacioni "të mirëkalkuluar dhe të shtrirë në kohë joshje dhe mashtrimi" të Ronit për blerje pronash të patundshme në New York.

(Trualli i Ambasadës tonë atje që pas prishjes, Roni do të ndërtonte kullë me skemën PPP?).

Për ta bindur për plotfuqishmërinë e tij në Shqipëri, Roni e ftoi në një udhëtim në Paris nga 6 deri 9 nëntor 2020 Markun me të shoqen, Juliia Faist, (ish-Mis Ukraina) ku celebruan datëlindjen e gruas së Ronit dhe "u prezantua nga Roni me kryeministrin shqiptar Edi Rama dhe ambasadorin shqiptar në Francë, Dritan Tola".

Kujtojmë se në tetor 2020 ishte ende në fuqi karantina e Covidit...

Në kallëzim, Mark Faist deklaroi edhe një udhëtim në Shqipëri me Ronin "ku u takuan dhe biseduan me shumë zyrtarë të lartë shtetërorë, ku udhëtuan me makina zyrtare me badigardë të armatosur, ku u akomoduan në një kompleks rezidencial shtetëror që ruhej nga persona të armatosur, me guzhinierë personale dhe me kamariere e personel të dedikuar".

Jo vetëm kaq.


Sipas kallëzimit, "Roni më premtoi edhe pajisjen me pasaportë shqiptare".

Gjithçka më sipër nuk ka nevojë për koment.

Nga 8.6 milionë dollarw, Roni i ka kthyer Markut vetëm 1 milionë dollarw. Marku kërkon "kthimin e diferencës 7.6 milionë dollarw, 5% interes kontraktual për çdo vit dhe pagimin e shpenzimeve për avokatin e tij dhe ato të procesit gjyqësor".

Roni është përgjigjur me kundërpadi ku i kërkon 30 milionë dollarw Markut "si pasojë e dëmtimit të reputacionit nga kallëzimi i tij dhe që ka sjellë për pasojë përjashtimin e Ronit nga një projekt madhor shqiptar ndërtimi ku humbi direkt 30 milionë \$ fitime të garantuara"...

Procesi gjyqësor vazhdon... /CNA





Të sugjeruara

Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë

E diela para Lartësimit të Kryqit/ Kryepiskopi Joan: Sprovat e jetës duhen parë si mundësi shërimi

Përplasja për pagat e magjistratëve/ Rama: Të gjithë të respektojnë Kushtetutën

Shuhen vatrat e zjarrit në të gjithë vendin

Gjergj Luca, sipërmarrësi që ngre qytete/ Fish City Apollonia, një ëndërr e bërë realitet

"Një situatë e tillë nuk është parë në botë"/ Pacolli: Aeroporti i Vlorës nuk duhet të mbetet peng i interesave të askujt

VIDEO/ Rrethohet Kryeministria, protestuesit zhvendosen në hyrjen e pasme të godinës

Zjarret dhe përmytjet në vend/ Ministria e Mbrojtjes përditësimet për situatën

Deputeti i PD-së nën hetim nga SPAK/ Këlliçi: Interesi i Ramës kërkon përndjekje të opozitës

FOTOLAJM/ Pankartat në protestën e 105-të kundër qeverisë, mesazhet e diasporës

Kërkohet dorëheqja e Ramës/ Nis protesta e 105 kundër qeverisë

Përplasjet për çështjen e pagave/ Gjyqtari Pëllumbi: SPAK mund të hetojë çdo person ndaj të cilit ka dyshime

105 ditë protestë kundër qeverisë/ Diaspora zbarkon në Tiranë

28 vjet nga vrasja e Azem Hajdarit/ Këlliçi: Vizioni dhe guximi e vendosën në krye të lëvizjes së dhjetorit

Çështja e pagave të drejtësisë/ Meta: Konflikti i provokuar nga Rama

CNA merr pjesë në IBC 2026/ Ngjarja kryesore e teknologjisë mediatike në Europë

Moti i keq përfshin qarkun e Elbasanit/ Përmytjen rrugët, vështirësi në qarkullim

Reshjet e shiut fikin zjarret/ Vetëm një vatër aktive

Trafiku i drogës nga Kolumbia/ Hita: Janë arrestuar disa shtetas shqiptarë, njëri prej tyre i dënuar për vrasje


Fillimi i vitit të ri shkollor/ Hita prezanton planin e masave


[editorial](#)

17:34 Editorial

Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?

CNA LIVESTREAM





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.